

Dënojmë fyerjet verbale drejtuar një gazetari të TV 21

Shkup, 19 tetor 2021 – Agjencia për Shërbime Mediatike dhe Audiovizuale dënon fyerjet e shprehura publikisht nga kandidatit i pavarur për kryetar të komunës së Kërçovës, Fatmir Limani drejtuar gazetares së TV 21, gjatë raportimit të saj për zgjedhjet lokale .

Jashtëzakonisht është e rëndësishme t'u mundësohet gazetarëve që të kryejnë detyrat e tyre profesionale pa probleme dhe në mënyrë të sigurt për të informuar publikun në kohën e duhur dhe në mënyrë të saktë. Në vend që të nënçmohet dhe ofendohet, duhet treguar respekt për profesionin e gazetarit dhe dinjitetin e punonjësve të medias.